

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat luksoze
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/nafta-fik-traktoret-fermeri-habitet-nga-cmimi-po-e-bl-ejme-njesoj-si-maki-i587062
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 11:23:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	edc120dfa62723b752e69ae51bb78b3ea2ad164b0bfaa43d45a75312d7c7e65b
TEKSTI	2fd653a0aa22f7c78dd44acf13c14d87eff05f7ea49df43d7b7ed8b7d15c5e4d
PAMJA	71edaef452a775255476ab5d9134a7090ff4a0322aa37aa00808b45f7555719d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2a27ea3c4e9ed1ea13d2f6b41d39eda516cdd093c2ca8f3c813e048fa8f62ff6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2a27ea3c4e9ed1ea13d2f6b41d39eda516cdd093c2ca8f3c813e048fa8f62ff6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le SHBA dhe Egjipti diskutojne krizat rajonale. Keshilltari i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguriaArtistet nga Prizreni vene ne skene dramen psikologjike "Pylli" ne fundit

Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat luksoze



19 Shtator 2026, 14:25Sociale TEMA



Çmimi i naftës për fermerët dhe blegtorët ka shkuar në afro 230 lekë, një kosto thuajse e papërballueshme për këta të fundit për të punuar tokat. Në fshatin Pinet të Tiranës, Xhaferr Tabaku ka disa krerë lopë, dhi dhe 3 traktorë që punon tokën. Por me naftën që ka shkuar në një çmim rekord, për të është e pamundur të ndezi traktorët.

"Kam 20 hektarë tokë më qira. Unë në muaj i harxhoj 4 milionë lekë të vjetra naftë. Dalin a nuk dalin, por me 4 milionë dalim të punojmë me shkëputje. Na thonë shkoni e mbushni atje në pikën e karburantit, atje shkon për t'u mbushur makina, jo traktori. Pse ma naftën që punon makina duhet të punojë dhe traktori? Asnjëherë s'kam marrë naftë me çmim të reduktuar. Shkojmë e mbushim në pikë të karburantit. Jashtë shteti ka dy lloje: ka për bujqësinë, ka për makinat. Këtu s'ka naftë për bujqësinë, se nuk të ndihmon qeveria. Të hapi pikë karburanti, shkon merr naftën, punon. Unë 20 vjet kam jetuar në Itali. Këto shtëpi i kam bërë jashtë shtetit, se këtu nuk bën shtëpi", thotë blegtori për A2 CNN.

Me 85 kuaj-fuqi dhe me një serbrator i cili mban më shumë se 200 litra naftë, Xhaferrri e ka të vështirë ta ndezë këtë traktor, pasi kostot e tij janë të papërballueshme. Në këtë pikë duhet të ndërhyjë shteti për t'u ofruar fermerëve dhe blegtorëve naftë pa taksa dhe pa akcizë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[Lehtësohen procedurat për pronat dhe oborret, trajtim "në bllok" dhe zero kosto për legalizimin e ndërtimeve](#)

19:40 Sociale / 3 komente

["Do thoni në djall ato që fituam", Rama paralajmëron supermarketet, kërkon transparencë për çmimet \(VIDEO\)](#)

16:20 Sociale / 52 komente

[Shqipëri–Slloveni, rritet bashkëpunimi ekonomik - Turizmi malor dhe përpunimi i drurit në fokus të diskutimeve për investime dhe partneritete të reja](#)

16:10 Sociale

[Kontroll agjencie funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara](#)

15:50 Sociale / 6 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.